

SHQIPËRIA AKTUALITET

## Sherr mes krushqve në Kamëz, plagoset vëllai i dhëndrit. Ndërhyn policia

14:58 | 29/05/2019

**Madhësia e tekstit : A A A**

Një konflikt familjar mes dy krushqive ka ndodhur në lagjen Valias i ri në Kamëz.

Sipas policisë, një shtetas me initiale M.V, 61 vjeç, banues në Kamëz është arrestuar në flagrancë, pasi pas një konfrontimi me krushkun e tij, ka nxjerrë armën dhe e ka plagosur lehtë me qytën e saj.

Uniformat blu kanë reaguar në kohë duke shmangur përshkallëzimin e një situatë që mund të përfundonte edhe më keq. Njëkohësisht janë shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e 4 shtetasve: A.V., D.V., S.N. dhe N.D.

Ndalimi i 2 shtetasve dhe shpallja në kërkim e 4 tjerëve u bë pasi nga veprimet operative ka rezultuar se janë përfshirë në konflikt si autorë të plagosjes së shtetasit N.D.

Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar një armë zjarri pistoletë me katër fishekë.

Materialet procedurale do t'i referohen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Tiranë për veprimet të mëtejshme.

**Njoftimi i plotë**

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 5 Kamëz, Tiranë, parandalojnë përshkallëzimin e mëtejshëm të një konflikti familjar ku është përdorur dhe arma e zjarrit

Shërbimet e Policisë kanë marrë njoftim se në lagjen Valias i ri, po ndodhte një konflikt midis dy familjeve (krushqi), ku ishte përdorur edhe arma e zjarrit.

Shërbimet e Policisë kanë reaguar në kohë dhe kanë arrestuar në flagrancë për veprën penale “Dhunë në famije”, “Plagosje e lehtë me dashje”, “Armembajtje pa leje”, shtetasin M.V, 61 vjeç, banues në Valias të Ri, Kamëz. Arrestimi i tij u bë pasi ka ushtuar dhunë fizike dhe ka plagosur lehtë me qytën e një arme, pistolette, shtetasin N.D., 43 vjeç, (vëllai i dhëndrit), i cili ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën.

**Lexo edhe :** [Nami në Kosovë, dy grabitje brenda pak minutave](#)

Gjithashtu është arrestuar në flagrancë për veprën penale “Dhune në famije” shtetasi A.D., 40 vjeç, banues në Valias, Kamëz, pasi në banesë dyshohet se ka ushtuar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj bashkëshortes.

**Lexo edhe :** [Nami në Kosovë, dy grabitje brenda pak minutave](#)

U ndaluan shtetasit S.V., 63 vjeç, banues në Kamëz, për veprën penale “Plagosje e lehte me dashje” dhe shtetasi SH.V., 28 vjeç, banues në Valias, për veprat penale “Plagosja rëndë me dashje”, “Armëmbajtje pa leje”.

Njëkohësisht janë shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e 4 shtetasve: A.V., D.V., S.N. dhe N.D.

Ndalimi i 2 shtetasve dhe shpallja në kërkim e 4 tjerëve u bë pasi nga veprimet operative ka rezultuar se janë përfshirë në konflikt si autorë të plagosjes së shtetasit N.D.

ETIKETA [‘krushqit’](#) [Kamëz](#) [policia](#) [sherr](#)

## Më shumë nga kategoria